



Republika Kosovo - Republic of Kosovo  
**Autoriteti i Konkurrencës**  
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority

**Vendimi Nr.119/23**

**Datë: 18.12.2023**

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe neni 55 nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr.01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e 18.12.2023, mori këtë;

## V E N D I M

I. LEJOHET. Përqendrimi i ndërmarrjeve Smartseller GmbH & Co. KG, dhe Flughafen Nürnberg Service Gesellschaft mit beschränkter Haftung, lidhur me marrjen e kontrollit të përbashkët mbi Smartsellen Flughafen Nürnberg GmbH & Co KG.

II. Parashtruesi i njoftimit për përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1,000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me nenin 18 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja (gjashtë mijë Euro).

## Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë; 25.10.2023, ka pranuar kërkesën me Nr. Prot. 503/23-11/H, lidhur me marrjen e kontrollit të përbashkët mbi Smartsellen Flughafen Nürnberg GmbH & Co KG, nga Smartseller GmbH & Co. KG, dhe Flughafen Nürnberg Service Gesellschaft mit beschränkter Haftung.

## Procedurat e ndjekura:

1. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 24.11.2023
2. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 24.11.2023
3. Më datë 19.10.2023 palët Smartseller GmbH & Co. KG, dhe Flughafen Nürnberg Service Gesellschaft mit beschränkter Haftung, kanë nënshkruar marrëveshja lidhur arrijen e kontrollit të përbashkët mbi Smartsellen Flughafen Nürnberg GmbH & Co KG.

**Smartseller GmbH & Co. KG**, kompani e regjistruar në regjistrin komercial të Gjykatës së Qarkut të Hamburgut në Gjermani, me numër të regjistrimit HRA 125280, me adresë të biznesit në Koreastrae 3, 20457 Hamburg - Gjermani.

**Flughafen Nurnberg Service Gesellschaft mit beschränkter Haftung**, është kompani e regjistruar në regjistrin komercial të Gjykatës së Qarkut të Nurembergut në Gjermani, me numër të regjistrimit HRB 4393, me adresë të biznesit në Flughafenstr. 100, 90411 Nurnberg, Gjermani.

**Smartsellen Flughafen Nürnberg GmbH & Co KG**, ndërmarrje e regjistruar pranë Gjykatës së Qarkut të Nurembergut në Gjermani, me numër të regjistrimit HRA 19884, me adresë të biznesit në Flughafenstr. 100, 90411 Nurembergut, Gjermani "smartseller FN"

### **Tregu përkatë:**

**Tregu i produktit:** Shërbimet e shitjes me pakicë të produkteve të udhëtimit dhe koncesion me shërbime ushqimore.

**Tregu gjeografik:** është treg ndërkombëtarë pasi qe ka shtrirje në gjithë Zonën Ekonomike Evropiane dhe në mbarë botën.

### **Analiza e konkurrencës**

Transaksioni i propozuar nuk do të shkaktoj ndonjë shqetësim për konkurrencën, duke pasur parasysh që Smartsellen Flughafen Nürnberg GmbH & Co KG nuk ka për qëllim të jetë fare e pranishme në Kosovë, dhe nuk ka ndonjë mbivendosje horizontale apo vertikale ndërmjet palëve. Transaksioni i propozuar nuk do të kufizojë ose shtrembëroje konkurrencën në Kosovë, struktura e ndërmarrjeve në tregun përkatës nuk do të ndryshoj edhe pas transaksionit dhe si e tillë nuk do të shpie në krijimin apo përforsimin e pozitës dominues në treg.

### **Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar**

Kërkesa për njoftim të përqendrimit është bërë për arsye se pala Smartseller është në kontrollin e përbashkët të GH dhe Orion. GH Gropu ka tre etnitete të regjistruara në Kosovë, të cilat kanë selin në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës.

- 1.Unifree Kosovo Sh.P.K. me numër unik;810814807,1
- 2.Unifree Kosovo Airoport SH.P.K me numër unik 810711392,2
- 3.Unitat Kosovo Retalling LL.C. me numër 810711417.3

Sipas vlerësimit të përqendrimit, nga ky transaksion nuk do të ketë efekte negative për konkurrencën, e rrjedhimisht për konsumatorët në Republikën e Kosovës, rrjedhimisht nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në tregun përkatës.

Komisioni i Konkurrencës ka vlerësuar se ky transaksion, nuk do të paraqesë efekte negative në konkurrencë, për arsye se ky transaksion /blerja nuk ndikon në forcimin e pozitës dominuese të ndërmarrjes blerëse tek operatorët ekonomik apo konsumatorët.

**Shënim:**

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti – konkurruese, do të jetë nën monitorimin e Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Neime Binaku-Isufi  
Kryetare



Kaltrina Sela  
Zv. Kryetare

Nafije Osdautaj  
Anëtare

Florent Mehmeti  
Anëtar

Salihe Gashi-Loku  
Anëtare

III. Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva